



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
QENDRA E KULTURËS, MEDIAS, BOTIMEVE TË MBROJTJES, MUZEUT TË FORCAVE
TË ARMATOSURA

PLANI I INTEGRITETIT

- *Përmbajtja*

- Përmbledhje Ekzekutive
- Objektivi 1: Rritja e transparencës dhe llogaridhënies
- Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore
- Objektivi 3: Forcim i mekanizmave të kontrollit të brendshëm
- Konkluzione dhe Rekomandime

PLANI I INTEGRITETIT

Ndërtimi i integritetit do të mbetet përherë një aspekt kyç i mirëfunksionimit të demokracisë e padyshim shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës.

Duke pasur në fokus luftën kundër korrupsionit në institucion dhe për rrjedhojë për të parandaluar rreziqet e mundshme, në kuadër të planit të integritetit, QKMBMMFA si strukturë varëse e Ministrisë së Mbrojtjes, ka marrë në analizë, pasi ka identifikuar fushat përkatëse, dy të tilla:

1.fushën e burimeve njerëzore

2.fushën e menaxhimit financiar dhe kontrolli i brendshëm

Nëse i referohemi fushës së parë të marrë në analizë evidentojmë riskun që lidhet me politikat e privatësisë dhe mungesës së trajnimeve të stafit .

Duke pasur në konsideratë që burimet njerëzore përbëjnë një prej elementëve kyç në sistemin e mbrojtjes, menaxhimi efektiv i tyre dikton marrjen e masave për të shmangur të tilla problematika dhe mbi të gjitha për të gjetur zgjidhjen drejt përmirimit të konsolidimit të sistemit.

Për rrjedhojë është shumë e rëndësishme dosjet personale të menaxhohen vetëm prej personit të autorizuar duke patur parasysh që informacioni që ato përmbajnë është tejet sensitiv.

Ruajtja e privatësisë dhe e të dhënave personale paraqitet si një nga më të rëndësishmet përcaktuar kjo edhe në rregullore ku ndër të tjera parashtrohet mënyra e administrimit të dosjeve ku vetëm personat e pajisur me certifikatë sigurie kanë akses në këtë sistem tejet sensitiv.

Nisur nga sa më sipër, pavarësisht ekzistencës së ligjit nr.9887, dt 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ende lind nevoja për njohjen e stafit me politikën e privatësisë dhe tërësinë e rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale.

Një tjetër risk i hasur gjatë analizës në fushën e burimeve njerëzore është edhe mungesa e mirëinformimit lidhur me detyrime që burojnë nga ligje të tilla si : ligji për konfliktin e interesit apo ligji për të drejtën për informim.

Referuar faktit se rekrutimi i stafit të Ministrisë bëhet në bazë të procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013 “për nënpunësin civil”, është me rëndësi të theksojmë se pranimi bëhet bazuar në shanse të barabarta si dhe meritës e aftësive profesionale, duke shmangur çdo lloj situatë që vendos në pikëpyetje transparencën në përzgjedhje apo që bie ndesh me ligjin për konfliktin e interesit.

Nevoja për trajnime të herëpaseshme për t’u updetuar me ndryshimet që pësojnë ligjet është një tjetër element që duhet marrë në konsideratë.

Në spektrin e fushës financiare, për prioritetet e 2024 diktohet nevoja për caktimin e një koordinatori risku i cili do të trajnohet për këtë qëllim.

Nga ana tjetër për realizimin sipas standarteve ligjore të procedurave për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve vepruese në çështjet e prokurimit vlen të theksojmë domosdoshmërinë që anëtarët e komisionit të bëjnë persona jo të lidhur, pra në mungesë të çdo lloj konflikti interesi qoftë me operatorët konkurrues edhe me operatorin e përzgjedhur si fitues. Niveli i lartë i transparencës duhet të udhëheqë të gjithë këtë proces. Për rrjedhojë është e nevojshme që në mënyrë të vazhdueshme anëtarët e komisioneve respektive të trajnohen vazhdimisht.

Vënia në zbatim e planit të integritetit do të jetë një shtysë për zhvillimin e mëtejshëm të strukturave shtetërore, për të forcuar shtetin e së drejtës.

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFAT I	AKTIVITETET	BURIMET
1. Mungesë informacioni në lidhje me politikat e privatësisë.	Cikël trajnimesh për të gjithë stafin e QKMBMMFA lidhur me politikat e privatësisë.	Spektori i Personelit Sektoret e tjerë	Mars 2025	Përfshirja e trajnimit mbi politikat e privatësisë në kalendarin vjetor të trajnimeve të QKMBMMFA. Organizimi i trajnimeve për politikat e privatësisë.	QKMBMMFA
2. Detyrat që burojnë nga ligje të tilla, si ligji për të drejtën e informimit, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ligji për konfliktin e interesit nuk janë të parashikuara në përkshkrimin e punës të punonjësit që kryen këto detyra.	Përfshirja, në përkshkrimet e punës, e detyrave që burojnë nga ligjet e tjera.	Spektori i Personelit	Tetor 2024	Rishikimi i përkshkrimeve të punës dhe reflektimi i detyrave që burojnë nga ligjet e tjera.	QKMBMMFA
3. Mungesa e trajnimit të rregullt në lidhje me	Përfshirja e trajnimit për	Spektori i Personelit	Dhjetor 2025	Hartimi i një kurrikule trajnimi	QKMBMMFA

RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETI	BURIMET
1. Mungesa e trajnimeve për koordinatorin e riskut.	Pjesëmarrja në trajnime të koordinatorit të riskut.	Koordinatori i riskut	Maj 2026	Trajnime të koordinatorit të riskut.	Koordinatori i riskut Sektori i Personelit
2. Mungesa e transparencës për të gjithë dokumentacionin e hartuar për procesin e prokurimit publik.	Përditësimi i programit të transparencës.	Komisioni i Prokurimeve Sektori web	Shtator 2025	Publikimi në programin e transparencës i regjistrit të parashikimeve dhe regjistri i realizimeve të prokurimeve publike.	Komisioni i Prokurimeve Juristi

1. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies”.

1. Fusha e menaxhimit financiar dhe prokurimeve publike.

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik”

Objektivi 1	Masa dhe Aktivitete	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve		
Përmirësimi i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore	1. Ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumentave dhe procedura e asgjësimit të tyre https://events.teams.microsoft.com/event/5ec45ce0-41ff-4b70-a178-acfbb0b10e41@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72	Masa të përealizuara për vitin 2023	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2023	Aktivitete në proces realizimi për vitin 2024
	2. Tema: Përdorimi i mediave sociale në Administratën Publike 1 https://events.teams.microsoft.com/event/50d7aa4b-36ac-4bc9-a8e2-45be46edf4f2@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 3. Tema: Përdorimi i mediave sociale në Administratën Publike 2 https://events.teams.microsoft.com/event/2dcc2f47-0591-475f-9c50-3179f908cfb1@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 4. Tema: Sulmet Phishing, metodat e reja të sofistikuar https://events.teams.microsoft.com/event/6739b362-2d06-4497-96f2-fe54c5f31173@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 5. Tema: Përdorimi i mediave në administratën publike 3 https://events.teams.microsoft.com/event/bb5aecc2-d745-4efb-a7ba-c480c3a4e571@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 (MUNGESË AKSESI) 6. "Menaxhimi i komunikimit" 7. "Vlerësimi i punës"	6	4	2

Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies	Masa/ Aktivitete 1. Tema: Analiza e tregut në fizibilitetin e projekteve https://events.teams.microsoft.com/event/ec4432a5-a7fd-41e0-9922-482db3656eeb@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 2. Tema: Analiza gjinore dhe monitorimi i buxhetit https://events.teams.microsoft.com/event/54d429ce-5f47-4dab-a9c6-44d7739e1e09@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 3.Tema: Analiza financiare në fizibilitetin e projekteve https://events.teams.microsoft.com/event/6a6ba5f4-ac35-44ed-8a8f-20db3036b4e6@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 4.Tema: Formulimi i projekteve https://events.teams.microsoft.com/event/5d7d28f8-ba31-4f17-9bfb-4fc9532cfc62@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 5. Tema: Konsiderata të përgjithshme për menaxhimin e zbatimit të projekteve https://events.teams.microsoft.com/event/7934e85c-c324-4cb5-ab1b-fe87c769ab9e@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72 6. Tema: Menaxhimi i palëve të interesuara në zbatimin e projekteve https://events.teams.microsoft.com/event/b377a11e-d7ef-439b-897b-51548fa48632@f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72			
--	---	--	--	--

Objektivi 2	7. ``Menaxhimi i riskut``			
Transparencë proaktive në fazat e prokurimit publik	(Pritet konfirmimin për formimin e një grupi tjetër pasui ishin plotësuar kuotat e pjesëmarrjes)			

Realizimi i objektivave të përcaktuara në planin e integritetit ka qënë një ndër elementët risi për strukturën e QKMBMMFA-së,parë kjo edhe në faktin se në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe eficencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Pasi jemi njohur në tërësi me elementët e integritetit dhe kemi përcaktuar fushat ku përfshihemi, faza tjetër me rëndësi ka qënë pikërisht realizimi i synimeve të përcaktuara dhe monitorimi për zbatimin e tyre.

Struktura e QKMBMMFA,ka parë si të nevojshme pjesëmarrjen e personelit në trajnime lidhur me funksionimin e politikave të privatësisë, politikat e antikorrupsionit dhe mirëfunksionimit të administratës publike,si një element thelbësor në procesin e rritjes dhe forcimit të kapaciteteve dhe transparencës me qëllim mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore.

Për rrjedhojë gjatë 6 mujorit të parë të monitorimit ,një pjesë e personelit ka arritur të aksesojë në trajnimet e realizuara qofshin këto online apo në auditore.

Përmes të qënurit prezent dhe ndjekjes së tyre është vënë re një përmirësim i ndjeshëm lidhur me realizimin edhe të detyrave funksionale dhe të paturit informacion lidhur me ndryshimet më të fundit sa i takon sektorit publik,të ofruara nga ASPA.

Megjithatë , një pjesë e personelit nuk ka mundur dot të ketë akses në platformën që përfshinte trajnimet referuar administratës publike, përdorimit dhe ndikimit të medias në administratë, si dhe njohuritë mbi metodat e reja të sofistikuara. Një situatë e tillë është raportuar edhe gjatë ditëve të përcaktuara për zhvillimin e takimit.

Ndërkohë një tjetër fushë me rëndësi paraqitet ajo financiare dhe e prokurimeve publike, sidomos sa i takon nevojës për një proces transparent në të gjithë hallkat e tij, parë kjo në kuadër të shtetit të së drejtës.

Nga ky objektivi i përcaktuar, pritet të zhvillohen në vijim trajnime lidhur me menaxhimin e riskut, për shkak se në bazë të raportimit të bërë numri i kuotave në fazën e parë përzgjedhëse ka qënë i plotësuar.

Vlen të theksojmë se në kuadër të kontrollit të brendshëm një tjetër objektivi o parashikuar është ai që lidhet me koordinatorin e riskut dhe politikat efikase për një administratë demokratike.

Të tilla objektiva të përcaktuara do të vazhdojnë të jenë nën monitorim përgjatë 6 mujorshit tjetër të planit të integritetit, me qëllim realizimin e tyre 100%.

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit të dërguar nga Ministria e Mbrojtjes.

Përgjatë vitit 2024 QKMBMMFA, si strukturë varësie e Ministrisë së Mbrojtjes ka realizuar një pjesë të objektivave të parashikuara nga Plan i Integritetit përgjatë vitit ,për të vijuar me realizimin final të tyre gjatë dy viteve pasardhëse:2025 dhe 2026, duke pëmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë dokument.

- Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e QKMBMMFA nëpërmjet faqes së internetit <https://www.mod.gov.al/ministria-2/strukturat-vartese/2017-04-21-11-26-45/6368-ndertimi-i-integritetit-i-qkmbmmfa>

Hapa të tjera

- Të vijohet me realizimin e objektivave të parashikuar në Planin e Integritetit.
- Të vijohet me realizimin e monitorimit me qëllim zbatimin final të planit të parashikuar në të gjitha objektivat e tij.

Të raportohet lidhur me ecurinë e monitorimit në strukturën përgjegjëse, Ministria e Mbrojtjes.